

01-3555_{DL} 18.10.2011
PRISHTINË - PRISHTINA



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE „IBËR - LEPENC“ SH.A.

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE „IBËR - LEPENC“ J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE „IBËR - LEPENC“ D.D.

Sheshi "Bil Clinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Clinton" Br.13 Prishtina, Kosovo
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber_lepenci.org

RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E KONTRATAVE

Prishtinë, Tetor 2011

1. MENAXHIMI I KONTRATËS

1.1. Kontrata për furnizim me mallra, shërbime apo punë, nënkshkruhet nga zyrtarët kompetent sipas ligjit të prokurimit, pas inicimit të procedurës nga njësia përkatëse e kërkesës dhe e lejuar nga Kryeshefi Ekzekutiv i Ndërmarrjes (KE).

1.2. Kontrata e shoqëruar me përshkrim të punëve i dërgohet edhe njësisë së kërkesës, me qëllim që e njëjta të propozoj personat përgjegjës për realizim, menaxhim dhe implementim të saj.

2. MENAXHIMI I KONTRATËS PËR PRANIM TË MALLËRAVE OSE SHËRBIMEVE

2.1. Në rastet kur kemi të bëjmë me pranim mallërash ose shërbime, komisioni përbëhet prej më shumë se një anëtari dhe numri gjithmonë duhet të jetë tek.

2.2. Komisioni i propozuar duhet të jetë profesional e në mungesë të stafit, së paku njëri prej tyre.

2.3. Komisionin për pranim të mallrave ose shërbimeve, në propozim të njësisë së kërkesës e formon KE.

2.4. Vendimi përveç komisionit dhe njësisë së kërkesës, i dorëzohet edhe departamentit ekonomik financiar, Departamenti për zhvillim dhe departamentit të prokurimit.

2.5. Komisioni për pranim, për kontratat e natyrës mallra dhe shërbime ka të bëjë direkt me implementimin e kontratës duke respektuar çdo nen të saj, i cili duhet t'i raportoi me shkrim Kryeshefit Ekzekutiv, njësisë së kërkesës, departamentit për zhvillim, departamentit ekonomik - financiar dhe departamentit të prokurimit për realizim të kontratës.

2.6. Nëse komisioni ka hasur në pengesa të realizimit p.sh malli ose shërbimi nuk është konform kontratës atëherë mallin apo shërbimin e tillë nuk do ta pranojë por do t'i kthejë kontraktorit, i cili i bartë shpenzimet e krijuara.

2.7. Kontraktorit, në bazë të propozimit të njësisë së kërkesës dhe aprovimit nga KE, mund t'i lejohet një afat kohor shtesë për eliminimin e vërejtjeve në kontratë, duke përcjellë afatin e garancionit për ekzekutim.

2.8. Në rastet kur ka vonesa të paarsyeshme të kontraktorit gjat ekzekutimit të kontratës duhet të raportohet në financa për numrin e ditëve të vonuara me qëllim që të vepohet me masa ndëshkuese siç janë paraparë në kontratë.

2.9. Nëse kontraktuesi kërkon zgjatjen e afatit për përmbushjen e kontratës, të njëjtën e shqyrton njësi e kërkesës e cila i ofron propozim konkret KE me arsyetimin përkatës.

2.10. KE në bazë të arsyetimit të ofruar dhe bindjes së tij merr vendimin meritore.

2.11. KE, kur e aprovon zgjatjen e afatit, ose e refuzon të njëjtën, i drejtohet departamentit të prokurimit për veprim të mëtutjeshëm në raport me kontraktuesin dhe subjektet tjera të ndërlidhura me kontratën konkrete.

2.12. Komisioni është përgjegjës për konstatimin e sasisë, kualitetit dhe çmimet e mallrave sipas kontrates.

2.13. Komisioni për pranimin e furnizimeve ose shërbimeve duhet të jetë në përbërje të ndryshme nga komisioni për vlerisimin e ofertave.

3. MENAXHIMI I KONTRATËS PËR PUNË NDËRTIMORE

3.1. Në rastet kur kemi të bëjmë me realizim të punëve ndërtimore (rehabilitime, ekzekutime e të ngjajshme) atëherë njësia e kërkesës në bashkëveprim me Departamentin për Planifikim dhe Zhvillim duhet të propozoj organin mbikqyrës (O.M),

3.2. Organi mbikqyrës duhet të jetë profesional dhe emërohet nga KE, në propozim të njësies së kërkesës.

3.3. Organi mbikqyrës bashkëpunon me departamentin për zhvillim, i cili bënë përcjelljen e investimeve kapitale.

3.4. Problemet eventuale, që mund të dalin gjat menaxhimit të kontratave, organi mbikqyrës do t'i zgjedh në bashkëpunim të ngushtë me udhëheqsin e departamentit për zhvillim dhe njësinë e kërkesës.

3.5. Organi mbikqyrës do të menaxhojë kontratën sipas planit për menaxhim të kontratës, i cili do të përpilohet para fillimit të zbatimit të saj.

3.6. Plani për menaxhim të kontratës do të përgatitet dhe do të nënshkruhet nga pala kontraktuese, organi mbikqyrës dhe të aprovohet nga Departamenti për zhvillim.

3.7. Kopja e një plani të tillë duhet të dorzohet edhe në departamentin e prokurimit dhe të financave, me qëllim që e njëjta të jetë pjesë e dokumentacionit të tenderit dhe kontratës.

3.8. Me fillimin e zbatimit të kontratës njoftohen të gjitha subjektet e involvuar në projekt (KE, njësia e kërkesës, Departamenti i prokurimit, Departamenti i financave, dhe Departamenti për Zhvillim). Gjithashtu, në rastet e ndërprejeve të punimeve duhet të bëhet njoftimi i të njëjtëve, me arsytet e ndërprerjes.

3.9. Njoftimi me shkrim bëhet nga organit mbikqyrës, duke i raportuar Departamentit për zhvillim, i cili i njofton të gjitha njësitë tjera përkatëse duke ia bashkangjitur edhe njoftimin e organit mbikqyrës.

3.10. Në rastet kur punët ndërprehen për shkak të kushteve të papërshtatshme për punë (kushtet klimatike), duhet të bëhet njoftimi për ndërprerje në formën e njëjtë si në paragrafin 3.9.

3.11. Zyrtari përgjegjës për menaxhim të kontratës - O.M ka përgjegjësinë e plotë për vërtetimin e sasisë, kualitetit dhe çmimit sipas kontratës duke pasur parasysh përcjelljen e secilit pozicion veç e veç.

3.12. Mënyra e pagesës rregullohet me kontratë. Situacioni pasues (pas të parit etj.) përfshin situacionet paraprake, me qëllim të shifet pasqyra e dhënë e realizimit e sidomos me situacionin përfundimtar.

3.13. Pagesa do të kryhet pas vërtetimit të punëve të kryera, konform situacionit të bazuar në kontratë nga organi mbikëqyrës dhe aprovimit nga Departamenti për Zhvillim.

3.14. Situacioni, s'bashku me faturë, nga arkiva e Ndërmarrjes, i dorëzohet organit mbikëqyrës, i cili, pas vërtetimit (pranimit) të njëjtin e përcjell për aprovim në Departamentin për zhvillim dhe dorëzohet për pagesë në Departamentin e financave.

3.15. Nëse kontraktuesit nuk i pranojnë punët, sipas situacionit të dorëzuar (nuk janë konform kontratës ose ka gabime aritmetikore në situacion apo nuk mund t'i vërtetohet sasia e faturuar etj.) situacioni i tillë i kthehet kontraktuesit, me arsyetimin e kthimit.

3.16. Me rastin e përfundimit të projektit, Organi mbikëqyrës njofton si me pikën 3.8. dhe 3.9.

3.17. Pas njoftimit të OM se kanë përfunduar punët, formohet komisioni për pranim të punimeve, i cili duhet të jetë profesional dhe të ketë më shumë se një anëtarë dhe me numër tek.

3.18. Komisioni për pranimin e punëve duhet të jetë në përbërje të ndryshme nga komisioni vlerësues i ofertave.

3.19. Komisioni ka për detyrë të kontrollojë dokumentacionin e udhëhequr nga OM dhe për paqartësi eventuale konsultohet me OM dhe Dep. për Zhvillim.

3.20. Komisioni verifikon sasitë dhe cilësinë e punimeve në terren duke u bazuar në kontratë dhe në rregullat e ndërtimit.

3.21. Komisioni raporton me shkrim përkitazi me realizimin e projektit, përkatsisht përmbushjen e kontratës.

3.22. Nëse komisioni ka ndonjë vërtetje të vogël e cila mund të eliminohet, atëherë veprohet analog me pikën 2.7.

3.23. *Komisioni për pranimin e punëve duhet të jetë në përbërje të ndryshme nga komisioni vlerësues i ofertave.*

4. GARANCONI I PUNIMEVE PËR KUALITETIN E KONTRAKTUAR

4.1. Njësia e kërkesës dhe D.P.ZH. përcjellin kualitetin e punimeve gjatë afatit garantues.

4.2. Në rast të vërejtjeve eventuale, përkatsisht paraqitjes së defekteve të ndryshme, njësia e kërkesës dhe D.P.ZH. me kohë, do ta njoftojnë me shkrim KE, departamentin e financave si dhe departamentin e prokurimit për ndërmarjen e masave për konfiskim të garancionit ose, nëse punimet janë në pajtim me kontratën, përkatsisht kualitetin e duhur kontrata konkrete mbyllet me skadimin e afatit garantues.

5. ANGAZHIMI I EKSPERTËVE TË JASHTËM PËR SHËRBIME KONSULENTE

5.1. Në raste kur Ndërmarrja ka projekte me të nderlikuara, në porpozim të njësive të kërkesës, KE mund të lejoj angazhim të eksperteve të jashtëm.

6. PËRFUNDIMI

6.1. Për mosrespektim të kësaj Rregulloreje do të ndërmerren masa dicitinore të parapara nga pundhënësi.

6.2. Kjo Rregullore hyn në fuqi pas kalimit të shtatë (7) ditëve nga dita e nënshkrimit nga KE dhe publikimit në Ndërmarrje.

KRYESHEFI EKZEKUTIV


Hajdar Beqa

